



## PROGRAMI AVANCOJMË KOSOVËN SË BASHKU – ALTERNATIVA LOKALE THIRRJE PËR APLIKIM RFA-01-AKT-LS

Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale (AKT - LS) është një projekt tre-vjeçar që synon rritjen e bashkëpunimit dhe ndërveprimit konstruktiv ndëretnik, kryesisht ndërmjet komunitetit shumicë shqiptar të Kosovës dhe komunitetit serb të Kosovës, e cila është jetike për sigurinë dhe stabilitetin e Ballkanit.

Programi bën thirrje për **Aplikime nga: Ndërmarrjet Mikro dhe te Vogla<sup>1</sup> si dhe bizneset fillestare**

### Përshkrimi i Projektit

Kjo kërkesë për aplikime për grant kërkon propozime nga ndërmarrjet ekzistuese Mikro dhe të Vogla dhe ato fillestare (start-up) në 16 komunat e mbuluara nga projekti AKT-LS për aktivitetet që mund të mos jenë të kufizuara në:

- Krijimin e vendeve të punës, me fokus primar në punësimin e grave dhe të rinjve jo-shumicë;
- Aktivitetet që mbështesin aftësimin për punë të grave dhe të rinjve jo-shumicë;
- Krijimin e mundësive ekonomike për të rinjtë dhe gratë jo-shumicë;
- Zgjerimin e zhvillimit të bizneseve dhe qasje në mundësitë e financimit për bizneset e komunitetit jo-shumicë, ndërmarrësinë e të rinjve dhe ndërmarrjet në pronësi të femrave.

### Informata mbi dhënien e grantit

Për çdo informatë mbi kontratën mund të kontaktoni z. Agron Selmani në 038 249 677/678 ose email ([grants@kcdf.org](mailto:grants@kcdf.org)).

Ju lutemi dorëzoni aplikacionin tuaj në zarf të mbyllur jo më vonë se më **10 prill, 2015 në 15:30 tek**: Agron Selmani, Menaxher për Grante, Zyra e Projektit Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale, rr. Sejdi Kryeziu Nr. 16, Pejton, Prishtinë **apo tek**: Branislav Nesovic, Koordinator Veri, AKTIV Office, rr. Cika Jovina Nr. 3, Mitrovica Veriore II/6. Çdo aplikacion i pranuar pas datës dhe kohës së caktuar për pranim do të konsiderohet si i vonuar dhe nuk do të kthehet përgjigje.

Takimet informative me aplikuesit potencial do të organizohen si vijon:

1. Asambleja Komunale në Pejë, adresa: 'Aleksandër Moisiu' p.n. Pejë më 16 mars, 2015 në ora 10:00
2. Zyra e AKTIV, adresa: Cika Jovina 3, Mitrovica veriore II/6, më 17 mars 2015 në ora 10:00
3. Asambleja Komunale Vushtrri më 17 mars 2015 në ora 14:00
4. Asambleja Komunale Graçanicë më 18 mars 2015 në ora 10:00
5. Shtëpia e Kultures, Kllokot më 18 mars 2015 në ora 14:00
6. Asambleja Komunale Shtërpçë më 19 mars 2015 në ora 10:00

Programi USAID/AKT – LS nuk do t'i mbulojë shpenzimet e pjesëmarrjes në takimet informative.

---

<sup>1</sup> Sipas ligjtit Nr.03/L-031, nje Ndermarrje konsiderohet Mikro nese ka 1 deri 9 punetore dhe konsiderohet e Vogel nese ka 10 deri 49 punetore.



Është shumë me rëndësi që ta vizitoni faqen tonë [www.kcdf.org/AKT-LS](http://www.kcdf.org/AKT-LS) për dokumentin e plotë të Kërkesës për Aplikim dhe detajet e dorëzimit të Aplikacionit.